VENDIM
Nr. 104/2024

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 69/2021, "PËR CAKTIMIN E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe neneve 21 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetares së Kuvendit dhe Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën I të vendimit nr. 69/2021, "Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit", i ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

- Deputeti Erjon Meka caktohet anëtar në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.
- Deputetja Teuta Ramaj caktohet anëtare në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.
- Deputetja Flutura Açka caktohet anëtare në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Elisa Spiropali

Miratuar në datën 7.11.2024.